

Accordo Quadro di Cooperazione Scientifica

L'anno duemilaundici, il giorno quindici del mese di novembre, nei locali del Rettorato dell'Università della Calabria, siti in Arcavacata di Rende (CS), Via Ponte P. Bucci Cubo 7/11b,

TRA

l'**Università degli Studi della Calabria in Italia** (di seguito denominata UNICAL), in persona del Prof. Giovanni Latorre, Rettore e legale rappresentante pro-tempore, domiciliato per la carica presso la sede dell'Università,

E

l'**Accademia delle Scienze d'Albania** (di seguito denominata ASHSH), in persona del Prof. Gudar Beqiraj, Presidente pro tempore, domiciliato per la carica presso la sede dell'Accademia,

premesso che:

- le Parti condividono l'interesse e l'impegno nel campo della cooperazione scientifica;
- le Parti, tenuto conto delle rispettive finalità istituzionali, intendono instaurare una fattiva collaborazione mediante l'utilizzo delle reciproche risorse intellettuali e tecnico-strumentali, al fine di promuovere, coordinare ed eseguire progetti di cooperazione, attività di ricerca, didattica ed alta formazione inerenti a temi rilevanti per l'Italia e l'Albania;
- è interesse comune la concertazione di forme integrate di collaborazione sul piano scientifico, didattico, culturale e dell'innovazione tecnologica;
- le Parti intendono condividere e coniugare conoscenze scientifiche ed esperienze dirette sul campo, al fine di migliorare il livello qualitativo complessivo e l'efficacia dell'offerta formativa e della ricerca scientifica nell'ambito dell'Albanologia e in tutti i campi di ricerca di interesse reciproco;
- la concertazione è stata già avviata in virtù di specifici progetti approvati e realizzati nell'ambito dei programmi di internazionalizzazione del MIUR e del recente accordo (2010) per lo scambio di materiale scientifico tra la Fondazione Universitaria "Francesco Solano", per conto dell'UNICAL, e l'Accademia delle Scienze d'Albania;

tutto ciò premesso, che costituisce parte integrante del presente accordo quadro, tra le Parti si conviene e si stipula quanto segue:

Art. 1

L'UNICAL e l'ASHSH si impegnano, per tutta la durata dell'accordo, a sviluppare mediante specifiche intese:

- 1) l'elaborazione, la progettazione e l'organizzazione di programmi di collaborazione scientifica e formativa su campi di comune e reciproco interesse;

- 2) la promozione di iniziative di informazione e sensibilizzazione rivolte alle rispettive comunità scientifiche di riferimento, attraverso l'organizzazione di convegni e seminari con la pubblicazione dei risultati dei lavori di ricerca su campi di interesse reciproco;
- 3) programmi di ricerca sul campo e sviluppo di tecnologie appropriate su tematiche rilevanti per lo sviluppo dell'Albania e di supporto a progetti di cooperazione internazionale;
- 4) azioni scientifiche comuni finalizzati alla valorizzazione del patrimonio linguistico e culturale degli Albanesi d'Italia;
- 5) trasferimento e scambio di competenze tra i contraenti.

Le Parti potranno, altresì, individuare e realizzare ulteriori modalità di collaborazione, nei termini ritenuti più idonei per il conseguimento dei fini oggetto dell'accordo.

Art. 2

Altri Enti, Istituzioni o Università - italiane e albanesi - interessati agli obiettivi dell'Accordo, potranno presentare formale istanza scritta di adesione, nella quale dovranno essere indicati la struttura operativa e il referente per la realizzazione delle attività di collaborazione.

Entro 30 giorni dal ricevimento della richiesta, le Parti congiuntamente si impegnano a rendere noto, mediante apposita comunicazione scritta, l'accoglimento della richiesta di adesione o, in caso contrario, il diniego motivato.

Art. 3

Le attività di cui ai precedenti articoli saranno svolte con personale di tutte le parti firmatarie. Le mobilità saranno regolate con le procedure in uso nelle relative strutture.

Art. 4

L'UNICAL e l'ASHSH individuano, rispettivamente, la Sezione di Albanologia e la Segreteria dell'Accademia delle Scienze d'Albania, come strutture operative per la realizzazione delle attività concertate.

Referenti dell'accordo di collaborazione sono:

- per l'UNICAL, il prof. Francesco Altimari, professore ordinario del SSD L-LIN 18 "Lingua e letteratura albanese";
- per l'ASHSH, il prof. dr. Salvator Bushati, Segretario Scientifico.

Art. 5

Le tematiche oggetto di attività congiunte, le modalità di utilizzo dei risultati raggiunti e gli accordi per specifiche visite, scambi o altre forme di collaborazione saranno, di volta in volta, concordati.

Art. 6

Il testo dell'accordo viene redatto in due versioni (italiano e albanese) e in duplice copia.

Il presente accordo di cooperazione non impone alcun obbligo finanziario dell'istituto ospitante.

Art. 7

Il presente accordo entrerà in vigore alla data della sua sottoscrizione e avrà una durata di 5 anni.

Per l'Università della Calabria
Il RETTORE
(Prof. Giovanni LATORRE)



Per l'Accademia delle Scienze d'Albania
Il PRESIDENTE
(Prof. Gudar Beqiraj)



Marrëveshje Kuadër për Bashkëpunim Shkencor

Më pesëmbëdhjetë nëntor të vitit dymijë e njëmbëdhjetë, në mjediset e Rektoratit të Universitetit të Kalabrisë, me seli në Arcavacata di Rende (CS), Via Ponte P. Bucci, Cubo 7/11b,

NDËRMJET

Universitetit të Kalabrisë në Itali (në vijim UNICAL), përfaqësuar nga Prof. Giovanni Latorre, Rektor dhe përfaqësues ligjor i përkohshëm i Universitetit

DHE

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (në vijim ASHSH), përfaqësuar nga Prof. Gudar Beqiraj, Kryetar i përkohshëm,

duke pasur parasysh se:

- palët i bashkon interesi dhe angazhimi në fushën e bashkëpunimit shkencor;
- palët, në përputhje me qëllimet përkatëse institucionale, dëshirojnë të vendosin një bashkëpunim konkret përmes përdorimit të burimeve të ndërsjella intelektuale dhe teknike, me qëllim që të promovojnë, të bashkërendojnë dhe të realizojnë projekte bashkëpunimi kërkimor, didaktik dhe trajnues mbi çështje të rëndësishme si për Italinë ashtu edhe për Shqipërinë;
- bashkërendimi i formave të bashkëpunimit në rrafshin shkencor, didaktik, kulturor dhe të rinovimit teknologjik është në interesin e përbashkët të palëve;
- palët kanë për qëllim të ndajnë dhe të ballafaqojnë njohuritë shkencore dhe përvojën e drejtpërdrejtë në terren, në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e përgjithshme të mësimdhënies dhe efikasitetin e kërkimit shkencor në fushën e Albanologjisë dhe në të gjitha fushat e kërkimit me interes të përbashkët.
- marrëdhëniet ndërmjet palëve tashmë kanë nisur falë disa projekteve të posaçme të miratuara dhe të realizuara në kuadrin e programeve të internacionalizimit të Ministrisë së Arsimit, Universiteteve dhe të Kërkimit (MIUR), si edhe të marrëveshjes së kohëve të fundit (2010) për shkëmbimin e materialit shkencor ndërmjet Fondacionit Universitar “Francesco Solano”, për llogari të UNICAL, dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë;

duke pranuar sa më sipër si pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje kuadër, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

UNICAL dhe ASHSH do të bashkëpunojnë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes, përmes projekteve të veçanta, për:

1), përpunimin, projektimin dhe organizimin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe didaktik në fushat me interes të përbashkët dhe të ndërsjellë;

- 2) promovimin e nismave të informimit dhe të ndërgjegjësimit, drejtuar komuniteteve përkatëse shkencore, nëpërmjet organizimit të konferencave dhe seminareve me botimin e rezultateve të punës kërkimore në fushat me interes të përbashkët;
 - 3) programe të kërkimit në terren dhe zhvillimin e teknologjive të përshtatshme mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin e Shqipërisë dhe në mbështetje të projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar;
 - 4) aktivitete të përbashkëta shkencore, që synojnë vlerësimin e trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore të arbëreshëve të Italisë;
 - 5) transferimin dhe shkëmbimin e kompetencave ndërmjet palëve.
- Palët mund të përcaktojnë dhe të realizojnë modalitete të mëtejshme bashkëpunimi, sipas mundësive më të përshtatshme për realizimin e objektivave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 2

Ente, institucione apo universitete të tjera - italiane dhe shqiptare - të interesuara për objektivat e marrëveshjes, mund të bëjnë kërkesë formale me shkrim për anëtarësim, në të cilën duhet të specifikohet struktura operative dhe referenti për realizimin e aktiviteteve bashkëpunuese. Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, palët bien dakord për të bërë të njohur, përmes komunikimit me shkrim, pranimin e kërkesës për anëtarësim, ose, në rast të kundërt, mospranimin e motivuar të saj.

Neni 3

Aktivitetet e përmendura më lart do të zhvillohen me stafin e të gjitha palëve nënshkruese. Mobiliteti do të rregullohet sipas procedurave aktuale të strukturave përkatëse.

Neni 4

UNICAL dhe ASHSH përcaktojnë, përkatësisht, Seksionin e Albanologjisë dhe Sekretarinë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si strukturat operative për realizimin e aktiviteteve bashkëpunuese. Referentët e marrëveshjes së bashkëpunimit janë:

- për UNICAL, Prof. Francesco Altimari, Profesor ordinar i "Gjuhës dhe letërsisë shqipe" (SSD L-LIN/18);
- për ASHSH, Prof. Dr. Salvator Bushati, Sekretar shkencor.

Neni 5

Temat që do të jenë objekt i aktiviteteve të përbashkëta, modalitetet e përdorimit të rezultateve të arritura, si dhe marrëveshjet për vizita të veçanta, shkëmbime a forma të tjera të bashkëpunimit do të përcaktohen rast për rast.

Neni 6

Teksti i marrëveshjes hartohet në dy versione (italisht dhe shqip) dhe në dy kopje. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk i imponon asnjë detyrim financiar institucionit pritës.

Neni 7

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të zgjasë për 5 vjet.

Për Universitetin e Kalabrisë
REKTORI
Prof. Giovanni LATORRE

Për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë
KRYETARI
Prof. Gudar BEQIRAJ